VENDIM
Nr. 54, datë 28.1.2026

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 51/2025, "Për rezervat materiale të shtetit", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (në vijim, DPRMSH) si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit, me seli në Tiranë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit financohet nga buxheti i shtetit, nga donacione të ndryshme, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Buxheti i DPRMSH-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit.

3. DPRMSH-ja ka si mision ndërhyrjen në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë dhe të ekonomisë në situata të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, çrregullimit të tregut, të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore, mjedisin, si dhe dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

1. DPRMSH-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në dy nivele:

a) në nivel qendror, si drejtori e përgjithshme;

b) në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale.

2. DPRMSH-ja përgjigjet për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë administrative të drejtorive rajonale.

3. DPRMSH-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson DPRMSH-në në marrëdhëniet me të tretët.

4. Drejtoritë rajonale janë struktura në varësi të DPRMSH-së, nën drejtimin e drejtorit rajonal dhe zbatojnë detyrat e ngarkuara për mundësimin e ndërhyrjes operacionale në nivel vendor e rajonal, që mbulon drejtoria rajonale, apo dhe kombëtar, në raste të shpalljes së gjendjes së luftës, të sulmeve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore.

5. Drejtoritë rajonale drejtohen, mbikëqyren dhe përfaqësohen nga drejtori i institucionit, i cili i raporton drejtorit të përgjithshëm të DPRMSH-së për realizimin e objektivave të përcaktuar dhe të detyrave të ngarkuara.

6. Drejtori i drejtorisë rajonale emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas legjislacionit për shërbimin civil.

7. DPRMSH-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare.

8. Stema e DPRMSH-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, ministria përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit", në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

9. Drejtoritë rajonale kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare.

10. Stema e drejtorive rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, ministria përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit (emri i degës territoriale)", në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

11. Vula e DPRMSH-së dhe vulat e drejtorive rajonale kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare". Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. DETYRAT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT DHE TË DREJTORIVE RAJONALE

1. DPRMSH-ja, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

a) Identifikon e vlerëson nevojën për hartimin ose ndryshimin e legjislacionit, lidhur me mirëmenaxhimin e rezervës materiale të shtetit;

b) Harton projektbuxhetin për realizimin e detyrave të DPRMSH-së, bën detajimin e buxhetit, si dhe monitoron përdorimin e fondeve përkundrejt planifikimit;

c) Bashkëpunon e koordinon me institucionet dhe strukturat përkatëse qendrore e vendore për lehtësimin e procedurave doganore dhe të kalimit të kufirit, në rastet e marrjes e të dhënies së ndihmave humanitare;

ç) Organizon trajnime të personelit, që do të ngarkohet me ngritjen e strukturave akomoduese të DPRMSH-së në vendet e përcaktuara për akomodim të kategorisë së popullsisë në nevojë;

d) Bashkëpunon me institucionet dhe strukturat në nivel qendror e vendor apo me institucionet e specializuara, lidhur me hartimin e planeve operacionale, me qëllim përfshirjen dhe mirëpërcaktimin e detyrimeve të rezervës materiale të shtetit;

dh) Bashkëpunon me institucionet drejtuese të strukturave të posaçme apo të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e situatave të gjendjes së luftës, të akteve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, të fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si pasojë e këtyre të dyjave, si dhe të çrregullimit të tregut, me qëllim garantimin e operacionalitetit të rezervës materiale të shtetit, në rast pamundësie teknike apo problemesh të tjera të mundshme, që mund të dalin gjatë ndërhyrjeve operacionale;

e) Bashkëpunon me institucionet e nivelit qendror apo dhe të tjera të përcaktuara me ligj në funksione koordinuese, për të garantuar dhënien e ndihmës humanitare vendeve të huaja, sipas legjislacionit përkatës dhe normave të së drejtës ndërkombëtare;

ë) Planifikon, organizon e shpërndan mallrat rezervë shteti për mbrojtjen e popullsisë dhe të ekonomisë, të pasurisë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit në situata të gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, të veprimeve terroriste, të çrregullimit të tregut, të cilat sjellin pasoja dhe dëme të mëdha për njerëzit, gjënë e gjallë dhe mjedisin;

f) Mban në gatishmëri dhe miradministron mallrat rezervë shteti;

g) Përdor kapacitetet operacionale, në mbështetje të operacioneve luftarake dhe joluftarake, të emergjencave civile në nivel vendor, rajonal e kombëtar, si dhe në mbështetje të ekonomisë, në rastet e çrregullimit të tregut;

gj) Jep ndihmë humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare, si dhe të planeve strategjike të institucionit;

h) Menaxhon e administron rezervat materiale të shtetit, në përputhje me planin strategjik afatmesëm dhe atë vjetor;

i) Planifikon plotësimin e rezervave materiale të shtetit, sipas nevojave dhe risqeve të parashikuara për ndërhyrjen operative në mbrojtje të popullsisë dhe të ekonomisë, gjatë situatave të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, çrregullimit të tregut, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisit, si dhe dhënien e ndihmave humanitare;

j) Organizon punën për garantimin në kohë të ndërhyrjeve operacionale të rezervës materiale të shtetit në situatat e gjendjes së luftës, të akteve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si dhe të çrregullimit të tregut;

k) Bashkëvepron me strukturat menaxhuese, planifikuese apo koordinuese të situatave të gjendjes së luftës, akteve terroriste, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si dhe të çrregullimit të tregut, në zbatim të vendimeve së tyre;

l) Garanton menaxhimin e mirëfunksionimin e rezervës materiale të shtetit, në çdo situatë, nëpërmjet zëvendësimit, freskimit, mirëmbajtjes, këmbimit, dhurimit e shitjes së rezervave materiale të shtetit.

2. Drejtoritë rajonale të rezervave materiale të shtetit kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:

a) Zbatojnë drejtimet strategjike dhe objektivat e përcaktuar nga DPRMSH-ja, lidhur me zëvendësimin, freskimin, mirëmbajtjen, këmbimin, dhurimin dhe shitjen e rezervave materiale të shtetit;

b) Menaxhojnë dhe administrojnë rezervat materiale të shtetit në përgjegjësi të tyre, në përputhje me planin strategjik afatmesëm dhe atë vjetor;

c) Planifikojnë nevojat e tyre për plotësim me mallra rezervë materiale të shtetit, për të siguruar gatishmërinë operative në mbrojtje të popullsisë dhe ekonomisë, gjatë situatave të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, çrregullimit të tregut, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisit, si dhe dhënien e ndihmave humanitare;

ç) Zbatojnë drejtimet strategjike lidhur me garantimin në kohë të ndërhyrjeve operacionale të rezervës materiale të shtetit në situatat e gjendjes së luftës, të akteve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, të fatkeqësive të tjera, të emergjencave civile, si dhe të çrregullimit të tregut;

d) Koordinojnë veprimtarinë në nivel vendor e rajonal me drejtuesit e pushtetit vendor menaxhues të situatave të emergjencave civile vendore e rajonale për ofrimin e ndërhyrjes operacionale të rezervës materiale të shtetit, sipas detyrave të ngarkuara nga DPRMSH-ja.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në momentin e miratimit të strukturës dhe të organikës të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, DPRMSH-ja vijon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës aktuale në fuqi.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama